



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-SKUPSHINA OPSTINE MALISEVO



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

ACCEPTED ON: 31/08/2026

PRIMLJENO:

02/266

Nr. 02/_____

Datë: 13.08.2026

Procesverbal

i mbledhjes së -II-(dytë) të rregullt të Komitetit për Komunitete

Koha: 13.08.2026 ora 09:00

Vendi: Salla e mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Fitim Shala si dhe anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Mbledhjen e udhëheqi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Fitim Shala meqenëse konstatoi se korumi ishte i mjaftueshëm për mbajtjen e seancës e hedhi në votim rendin e ditës si në vijimë:

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Teuta Miftari-Mazreku.
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua unanimitet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komitetit për Komunitete.

Rezultati i votimit: 3 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komitetit për Komunitete.

Rezultati i votimit: 3 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Takim me drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Teuta Miftari-Mazreku.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z. Fitim Shala: Të nderuar anëtarë të Komitetit, ne për këtë takim e kemi ftuar drejtoreshën por ajo sot nuk ka pasur mundësi me marrë pjesë mirëpo e ka deleguar zyrtarin për sport z. Albert Morina, të cilit ne i dëshirojmë mirëseardhje. Fjalën ja kalojë zyrtarit për sport.

Albert Morina zyrtar i sportit-DKRS: Përshëndetje për të gjithë! Ju faleminderit për ftesën. Unë në pika të shkurta do të mundohet me ju informuar për disa nga aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij viti. Ne kemi mbajtur një turnir me institucionet e komunës së Malishevës me të cilën kanë marrë pjesë tetë ekipe e cila është mbajtur në palestrën sportive "Habib Zogaj". Për nder të festës së 16 Qershorit Ditës së Çlirimit në Malishevë kemi mbajtur program festiv në shesh me të cilën kanë marrë pjesë artist të ndryshëm. Ne kemi mbajtur turnirin sportiv i cili është tradicional Ibrahim Mazreku me të cilën kanë marrë pjesë për afërsisht 80 ekipe prej të gjithë Kosovës. Për shkak të mungesës së buxhetit shumë aktivitete të cilat janë planifikuarë nuk kanë pasur mundësi me u realizu.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z. Fitim Shala: Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe prezantimin e punës tuaj, uroj që buxhetit të rritet dhe të ketë mundësi më të madhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive të cilat janë shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për rinin tonë.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës: Të ndryshme.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z. Fitim Shala: Unë edhe një herë ju ftoj dhe ju inkurajojë që nëse keni pregaditur ndonjë projekt, ju lutem sjelleni dhe ne do të mundohemi që ato të përfshihen në projekt buxhet.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i përfundoi punimet e mbledhjes rreth orës 09:30.

Malishevë Gusht, 2026

Procesëmbajtsja

Kryesues i Komitetit për Komunitete

Fatlume Delija

